



në bashkëpunim me:



Info/Press: contact.tica@gmail.com // mail@the-maps.org

Website: www.tica-albania.org // www.the-maps.org

PREZANTIMI I ARTISTËVE - TICA AIRLAB 2016 programi i residencës

E hënë 16 Maj, 2016, ora 19.00

tek: TULLA Culture Center, Rruga Hiqmet Delvina, Tirana/Albania

T.I.C.A ka kënaqësinë tu ftojë në eventin e prezantimit të artistëve në **residencë** për **sezonin e pranverës**. Nga 2016 TICA AIRLAB do të zhvillohet në bashkëpunim me **MAPS - Museum of Art in Public Space** dhe Stefano Romano do të jetë kurator/koordinator i sezonit të pranverës. Artistët në rezidencë:

SILVA AGOSTINI (Shqipëri /Gjermani)
BRANISLAV NIKOLIĆ (Republika e Serbisë)
SU TOMESSEN (Holandë)

Do të prezantojnë për publikun projekte të mëparëshme dhe do të flasin për praktikën e tyre artistike, në një event të hapur dhe informal.

Mbi artistët:

SILVA AGOSTINI:

Silva Agostini, e lindur në vitin 1979, jeton dhe punon në Berlin. Ajo ka studjuar pranë Akademisë së Arteve në Tiranë dhe Universitetit të Arteve në Berlin (studente masteri e Christiane MOBUS). Puna e saj është ekspozuar në shumë ekspozita vetjake dhe në grup në Gjermani dhe Europë, ku ndër të tjera mund të përmendim ato në Nassauischer Kunstverein, Wiesbaden, Muzeun e Artit Bashkëkohor të Maqedonisë, në Selanik, Galerinë Kombëtare në Tiranë dhe në Bienalen e Tiranës. Ajo është një anëtare themeluese e Projektit të Hapësirës "TAT" në Berlin.

BRANISLAV NIKOLIĆ:

Ka lindur në vitin 1970 in Šabac, Serbi. Ai është diplomuar në Akademinë e Arteve të Bukura në Novi Sad, Serbi, dega Pikturë, në vitin 1996. Ka marrë një diplomë pasuniversitare pranë Institutit të Artit Hollandez, Enschede, në Hollandë në vitin 2001 dhe pranë Akademisë së Arteve të Bukura në Novi Sad, Serbi në vitin 2002. Prej vitit 1995 ai është anëtar i Shoqatës së Artistëve të Arteve të Bukura të Serbisë. Prej vitit 2002 ai është përzgjedhës për Jalovik Art Colony (www.jalovik.net). Punon në skulpturë, pikturë, design dhe si kurator. Branislav Nikolić i ka ekspozuar punët e tij në mënyrë të pavarur dhe së bashku me artistë të tjerë, qoftë në vendlindje qoftë jashtë saj. Ai jeton dhe punon në Beograd, Serbi.

SU TOMESSEN:

Artistja vizuale Su Tomesen është vendosur në Amsterdam dhe Jogjakarta. Puna e saj përbëhet nga video, fotografi e instalacione, dhe përqendrohet në ekonomitë informale dhe naivitetin në hapësirën publike. Formimi i saj paraardhës si historiane dhe puna si regjisore – është i integruar me punën e saj. Pas ndjekjes së një Masteri në Arte të Bukura në Institutin Sandberg në Amsterdam ajo ka qenë artiste rezidence në Aman, Johannesburg, Medelín. Ajo gjithashtu ka punuar për një videoprojekt në Port-au-Prince, Rio de Janeiro dhe Buenos Aires.

TICA AIRLAB 2016 u mundësua nëpërmjet mbështetjes së Ministrisë së Kulturës së Shqipërisë.

Për sezonin e pranverës programi po bashkëpunon edhe me Fondin Mondriaan, që po mbështet rezidencën e artistes holandeze, Su Tomesen.

